


**mos supozo  
nevojat e mia.**





# mos supozo nevojat e mia.

Ky material është financuar nga Save the Children. Përgjegjësia për përmbajtjen qëndron tërësisht me krijuesin. Save the Children jo domosdoshmërisht i ndanjë pikëpamjet dhe interpretimet e shprehura.



## **Përmbajtja**

|  |    |
|--|----|
| Hyrje  | 8  |
| Hulumtimi në terren  | 16 |
| Metodologjia   | 16 |
| Mostra   | 17 |
| Të arriturat kryesore  | 20 |
| Rezultatet   | 24 |
| 1. Nevoja për përfshirje dhe mbështetje në procesin mësimor                                | 24 |
| 2. Nevoja për përdorim të metodave konkrete gjatë orës mësimore                            | 26 |
| 3. Nevoja për shoqëri  | 29 |
| 4. Nevoja për aktivitete jashtë-shkollore dhe lëndë kulturore si Art Figurativ dhe Muzikor | 31 |
| 5. Nevoja për mësimdhënës/e mbështetës/e   | 35 |
| 6. Nevoja për diagnostikim të saktë  | 38 |
| 7. Nevoja për infrastrukturë të përshtatshme   | 39 |
| Fokus Grupet   | 41 |
| 1. Nevoja për përfshirje dhe mbështetje në procesin mësimor                                | 42 |
| 2. Nevoja për përdorim të metodave konkrete gjatë orës mësimore                            | 44 |
| 3. Nevoja për shoqëri  | 45 |
| 4. Nevoja për aktivitete jashtë-shkollore dhe lëndë kulturore si Art Figurativ dhe Muzikor | 45 |
| 5. Nevoja për mësimdhënës/e mbështetës/e   | 46 |
| 6. Nevoja për diagnostikim të saktë  | 48 |
| 7. Nevoja për infrastrukturë të përshtatshme   | 49 |
| Konkludime dhe Rekomandime   | 52 |

**hyrje**



## Hyrje

Raporti në vijim është përpiluar në kuadër të projektit “Mos supozo nevojat e mija” të zbatuar nga Këshilli Rinor Kosovar, nën mbështetje të Save the Children. Ky projekt ka për qëllim identifikimin e nevojave kryesore të fëmijëve me nevoja të veçanta në arsimin fillor në Kosovë. Veçanërisht, projekti në fjalë, ka si qëllim të sjellë në pah nevojat e nxënësve të ciklit të lartë të arsimit fillor (klasët 6-9), përmes hulumtimit, nën përdorim të metodave si intervistimi i fëmijëve, takimet me hisedarë, të tipit si: diskutim apo grumbullim mendimesh përmes pjesëmarrjes së tyre në tryeza të rrumbullakëta, si dhe nga diskutimet mbi të gjeturat e hulumtimit në terren me fëmijë me nevoja të veçanta dhe ata me zhvillim tipik.

Nga baza e njohurive që Këshilli Rinor Kosovar posedon, deri më tani nuk ka informacion nëse janë hulumtuar nevojat e fëmijëve me nevoja të veçanta në mënyrë të drejtëpërdrejtë në sistemin fillor arsimor.

Analiza e Situatës realizuar nga UNICEF (2017), mund të konsiderohet si një ndër dokumentet që trajton situatën e fëmijëve me nevoja të veçanta në Kosovë. Andaj, përgjatë raportit, i jemi referuar analizës përkatëse si bazë për të përshkruar gjendjen e fëmijëve me nevoja të veçanta. Deri më tani, të dhënat statistikore të institucioneve të Kosovës nuk tregojnë një numër të caktuar të fëmijëve me nevoja të veçanta, apo të përfshirjes së tyre në insitucione shkollore.

Legjislatura e Kosovës në raport me fëmijët me nevoja të veçanta ka pësuar përmirësime përgjatë viteve të fundit. Në kuadër të nenit 6 të Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsim Parauniversitar në Republikën e Kosovës (në vazhdim “Ligji për Arsimin Parauniversitar”)<sup>1</sup> qasja dhe përparimi nëpër të gjitha nivelet e arsimit dhe aftësimin parauniversitar mundësohet në pajtim me dispozitat e Ligjit nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi (në vazhdim “Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi”)<sup>2</sup> në baza ekzistuese apo të supozuara, siç është ai gjinor, racor, i fesë, i orientimit seksual, i paaftësisë

1 Ligji nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Kuvendi i Republikës së Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, shtator 2011  
<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2770>

2 Ligji nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Kuvendi i Republikës së Kosovës, Gazeta Zyrtare, qershor 2015  
<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10924>



fizike apo intelektuale, apo çfarëdo paaftësie tjetër, i opinioneve politike apo të tjera, i përkatësisë kombëtare, etnike ose shoqërore, i lindjes ose i ndonjë gjendje tjetër të nxënësit apo familjes së tij.

E rëndësishme për tu përmendur dhe shtjelluar është përdorimi i dy nocioneve, atij “fëmijë me paaftësi” dhe “fëmijë me nevoja të veçanta”. Nocioni “fëmijë me paaftësi” i referohet ndonjë paaftësie fizike, mentale, intelektuale dhe shqisore, e cila në bashkëveprim me faktorë të tjerë pengues, e pamundëson pjesëmarrjen e tyre të plotë, efektive dhe të barabartë me të tjerët në shoqëri (CRDP, 2006). Në anën tjetër, nocioni “fëmijë me nevoja të veçanta” i referohet nevojave specifike që fëmijët me paaftësi mund t’i kenë në procesin mësimor-shkencor. Prandaj, përgjatë raportit në vijim, i jemi referuar nocionit “fëmijë me nevoja të veçanta.”

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) ka përgjegjësi të hartojë dhe zbatojë akte ligjore dhe nën-ligjore që zhvillojnë cilësinë e arsimit, duke promovuar një sistem arsimor jo-diskriminues, në të cilin respektohet e drejta e secilit person për arsim, dhe ku mundësia e shkollimit cilësor është e drejtë e të gjithëve. Hartimi i dokumenteve për mbrojtje dhe zhvillim të fëmijëve në Kosovë është në linjë të drejtë me nevojat e fëmijëve, mirëpo implementimi i legjislaturës ka hapësirë të madhe për përmirësim. Analiza e situatës e realizuar nga UNICEF, konsideron fëmijët me paaftësi si një ndër grupet më të margjinalizuara në Kosovë (Analiza e Situatës, 2017). Më veçanërisht, nga raporti i Ombudspersonit (2015), situata e fëmijëve me paaftësi në Kosovë konsiderohet si e palakmueshme. Kosova ballafaqohet me nivel të ulët të infrastrukturës, e cila si rrjedhojë kufizon lëvizjen e fëmijëve me nevoja të veçanta në institucione shkollore. Për më shumë, fëmijët në Kosovë ende ballafaqohen me probleme si diagnostikimi i gabuar, mungesa e diagnostikimit, mungesa e mjeteve konkretizuese për diagnostikim, mungesa e mësuesëve/eve mbështetës/e, mungesa e profesionistëve për identifikimin e paaftësive, e posaçërisht në raste të identifikimit të paaftësive komplekse dhe komorbide (në rast të paraqitjes së dy paaftësive në të njëjtën kohë).

Identifikimi i ‘paaftësisë’ në Kosovë është i kufizuar në tri kategori të paaftësisë: paaftësi vizuale, paaftësi e të dëgjuarit; para/tetraplegjia. Për

më shumë, legjislacioni për fëmijë/persona me paaftësi është ekzistues dhe përfshinë paaftësinë fizike, shqisore dhe mentale; mirëpo nuk ekziston asnjë rregullore për përcaktimin e identifikimit dhe vlerësimin të paaftësisë mentale.

Duke u bazuar në të dhënat e Qendrës për Shëndet Mental, në kuadër të Klinikës Universitare në Kosovë, prindërit dhe kujdestarët e fëmijëve me paaftësi orientohen për diagnostikim, për qëllim të pranimin të mbështetjes financiare. Kjo rrjedhon në sfidën tjetër, që ka të bëjë me nivelin e ulët të vetëdijesimit për identifikim të hershëm të paaftësive dhe të të kuptuarit e ndikimit të paaftësive në zhvillimin e fëmijës. Vërehet një trend i kërkesave të prindërve për identifikim të spektrit të autizmit, duke mos qenë të vetëdijshëm për ekzistencën e problemeve sensorike, të cilat mund t'i ngjasojnë shenjave të autizmit. Këto probleme sensorike të paraqitura tek fëmijët, janë rezultat i stimulimit të pamjaftueshëm të tyre nga prindërit, apo edukatorët në institucione parashkollore.

Sipas nenit 37, pika 1 e Ligjit për Arsimin Parauniversitar, personat e kualifikuar sipas standardeve të specifikuara në një akt nënligjor, mund të zgjidhen nga komuna në institucionet arsimore për të ofruar shërbime profesionale, duke përfshirë: kujdesin mjekësor, mbështetjen pedagogjike-psikologjike, si dhe punën këshilluese apo sociale. Andaj, komisionet mjekësore konsiderohen të jenë pjesë e secilit proces të identifikimit të fëmijëve me nevoja të veçanta në të pranuar në institucionin arsimor, apo në të vërejtur të parë të ndonjë ngecje në të nxënë. Në rastet kur parashihet që fëmija nuk mund t'i arrijë rezultatet në disa lëndë mësimore, apo fusha të aktiviteteve, fëmijës duhet të i mundësohet një sesion i vlerësimin psikologjik për të identifikuar ndonjë problem në të shprehur, apo në të nxënë. Sipas, Planit Individual të Arsimin ( në vazhdim “PIA”) dhe Udhëzuesit për hartimin e PIA për fëmijët me nevoja te veçanta arsimore<sup>3</sup> kur ekipi vlerësues komunal apo ekipi i shkollës, vlerëson se një fëmijë ka nevojë për mbështetje arsimore, atëherë atij fëmije i hartohet Plani Individual Arsimor

PIA duhet të zhvillohet përmes një procesi bashkëpunues, duke përfshirë

3 Plani Individual i Arsimin (PIA) dhe Udhëzuesi për Hartimin e Planit Individual të Arsimin për Fëmijë me Nevoja të Veçanta Arsimore, Ministria e Arsimin, Shkencës dhe Teknologjisë, 2017  
[https://resourcecentre.savethechildren.net/node/15078/pdf/plani\\_individual\\_i\\_arsimit.pdf](https://resourcecentre.savethechildren.net/node/15078/pdf/plani_individual_i_arsimit.pdf)

shkollën, prindërit, fëmijët (kur është e përshtatshme) dhe pedagogun apo psikologun/en përkatës/e. Në PIA përcaktohen qëllimet për nxënie të fëmijës, ato afatshkurte dhe afatgjata. Qëllimi kryesor i PIA-s është që të mbështesë edukimin e fëmijës, në mënyrë që ai/ajo të përfitojë më së shumti në kuadër të mundësive dhe potencialit të tij/saj, dhe/apo të ndjekë arsimin në bazë të kurrikulës së rregullt për aq sa është e mundur. Individualizimi i përmbajtjes së lëndëve mund të bëhet vetëm në ato lëndë në të cilat fëmija ka vështirësi të theksuara, kurse në lëndët e tjera fëmija mund të ndjekë materialin sipas kurrikulës së rregullt. Mirëpo, kjo nuk e bënë të domosdoshme që fëmija të ketë gjithmonë nevojë për ndonjë individualizim të lëndëve, në disa raste fëmija ka nevojë vetëm për mjete konkretizuese didaktike apo mësimore, si p.sh., libra në alfabetin e Brajlit, mjete tekniko-teknologjike apo mjete ndihmëse si: zmadhues, fotografi, ilustrime, lodra logjike etj.

Më specifikisht, PIA përcakton:

- Qëllimet edukative, arsimore të fëmijës për periudhën që zgjat plani individual
- Rezultatet e nxënies të fëmijës, përmes të cilave realizohet qëllimi i synuar
- Metododat dhe format e punës, të nevojshme për të realizuar rezultatet e nxënies
- Burimet e nevojshme për shërbimet që duhet ofruar si dhe burimet ekzistuese
- Përmbajtjen e individualizuar të lëndëve mësimore ose të fushave të aktiviteteve<sup>4</sup>

Të arriturat e nxënies së fëmijës duhet të jenë konkrete, reale, të matshme dhe të monitorohen dhe testohen më së largu brenda 2 vitesh. Nëse, mësimdhënësi vlerëson që fëmija ka arritur qëllimet më parë sesa është përcaktuar, atëherë qëllimet duhet të rishkruhen mbi gjendjen aktuale të fëmijës, pavarësisht nga përcaktimi i kohës. Vlerësimi i nxënësve me

4 Plani Individual i Arsimit (PIA) dhe Udhëzuesi për Hartimin e Planit Individual të Arsimit për Fëmijë me Nevoja të Veçanta Arsimore, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, 2017  
[https://resourcecentre.savethechildren.net/node/15078/pdf/plani\\_individual\\_i\\_arsimit.pdf](https://resourcecentre.savethechildren.net/node/15078/pdf/plani_individual_i_arsimit.pdf)

nevoja të veçanta duhet të bëhet sipas, Nenit 15 të Udhëzimit Administrativ nr.08/28 për Vlerësimin e Nxënësve<sup>5</sup> (në vazhdim “UA për Vlerësimin e Nxënësve”) mbështetur në Kornizën e Kurrikulës të Arsimit Parauniversitar<sup>6</sup> të Republikës së Kosovës (në vazhdim “Korniza e Kurrikulës”), i cili përcakton që vlerësimi i nxënësve me nevoja të veçanta (që kanë vështirësi të theksuara në të nxënë) bëhet në harmoni me rezultatet e të nxënës, të përcaktuara në Kurrikulë dhe në PIA.

Mësimdhënësi/ja mbështetës/e përpilon PIA bashkë me mësimdhënësin e rregullt, prindin dhe anëtarët e tjerë të ekipit të PIA-s, dhe po ashtu ndihmon në vetëdijësimin e stafit të shkollës për procesin e

gjithëpërfshirjes. Për më shumë, këshillon dhe ndihmon mësimdhënësit e rregullt se si të punohet me fëmijët me nevoja të veçanta arsimore, dhe si të menaxhohet me klasën gjithëpërfshirëse.

Gjithëpërfshirja në arsim ka synim përfshirjen e të gjithë fëmijëve pa dallim race, gjinie, etnie, paaftësie, apo ndonjë dallim tjetër në klasa të rregullta në shkollën më të afërt të rregullt.

Arsimi gjithëpërfshirës është pjesë integrale e të gjitha politikave të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe hynë në kategorinë e reformave të reja të Kosovës, si një praktikë e re pas vitit 1999. Sidoqoftë, përkundër ndryshimeve legjislative, Kosova ende sfidohet dhe bën përpjekje drejtë realizimit të kësaj reforme.

Si rrjedhojë, marrë parasysh mungesën e madhe të informacionit për situatën në terren, për të matur zbatimin e drejtë të kornizës legjislative si dhe për të zbërthyer situatën, Këshilli Rinor Kosovar ka konsideruar si të nevojshëm hulumtimin me bazë perspektivën e fëmijëve të cilët prekën drejtëpërdrejtë. Kësaj, ky raport ka paraqitur informacion që ndihmon kuptimin e nevojave të fëmijëve me nevoja të veçanta në shkolla fillore. Për të plotësuar kuptimësinë, pjesa më e madhe e hulumtimit është zhvilluar në terren, si dhe janë organizuar takime e tryeza që i kanë kontribuar diskutimit

5 Udhëzim Administrativ nr. 08/2016 për Vlerësimin e Nxënësve sipas Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës, Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, 2016

[https://masht.rks-gov.net/uploads/2016/08/ua-nr-08-2016-per-vleresimin-e-nxeneseve\\_1.pdf](https://masht.rks-gov.net/uploads/2016/08/ua-nr-08-2016-per-vleresimin-e-nxeneseve_1.pdf)

6 Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, gusht 2016

<https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/03/korniza-kurrikulare-finale.pdf>

me hisedarë dhe me fëmijë me nevoja të veçanta dhe ata me zhvillim tipik.  
Të gjeturat e hulumtimit janë shpalosur më poshtë.

**hulumtimi  
në terren**



## Hulumtimi në terren

Hulumtimi për identifikimin e shtatë (7) nevojave kryesore të fëmijëve me nevoja të veçanta në ciklin e lartë të Arsimit Parauniversitar (klasët 6-9), është realizuar në 50 institucione shkollore në shtatë (7) regjione të Kosovës: Prishtinë, Gjakovë, Ferizaj, Pejë, Prizren, Mitrovicë Jugore dhe Gjilan. Ekipi hulumtues në bashkëpunim me Drejtoritë Komunale të Arsimit (në vazhdim “DKA”) ka identifikuar të gjitha institucionet shkollore të cilat vijohen nga fëmijët me nevoja të veçanta. Më vonë megjithatë, ekipi hulumtues ka kontaktuar secilin/ën drejtor/e të institucioneve shkollore për të konfirmuar apo modifikuar listën e pranuar të nxënësve dhe kësisoj për të vazhduar procesin e hulumtimit.

## Metodologjia

Hulumtimi i realizuar është cilësor, andaj mbledhja e të dhënave në terren është bërë me anë të intervistave gjysmë të strukturuar me nxënësit. Intervistat janë mbajtur në objektet shkollore, mirëpo nuk është penguar procesi mësimor. Intervistat janë realizuar nga 10 hulumtues të angazhuar në terren, absolventë të degës së Psikologjisë së Përgjithshme në Universitetin e Prishtinës.

Fillimisht, për të lehtësuar procesin e intervistimit dhe për të siguruar pjesëmarrje konfidenciale të fëmijëve në proces, hulumtuesit kanë siguruar leje-pëlqimin nga udhëheqësit e institucioneve arsimore dhe të prindërve. Të gjithë kujdestarët e pjesëtarëve të mostrës kanë nënshkruar fletë pëlqimin, në të cilën, përpos tjerash, kanë siguruar konfidencialitetin e të dhënave të mbledhura (Aneks). Intervistat gjysmë të strukturuar janë përcjellur me pyetësor gjysmë të strukturuar. Sidoqoftë, hulumtuesit kanë realizuar intervistën si një bisedë të hapur me pjesëtarët, duke ofruar mundësi më të qasshme karshi lirisë së shprehjes, gjithnjë duke marrë parasysh faktorët si nevoja për mjete dhe metoda konkrete mësimore, nevoja për shoqëri, nevoja për mbështetje mësimore, të cilët janë hulumtuar. Në raste më të veçanta, kur nxënësi/ja e ka pasur të pamundur të përfundojë intervistën vet, dhe të tillët kanë pasur mësimdhënës mbështetës, intervista është realizuar në prezencë të mësimdhënësit/es mbështetës/se.



Kohëzgjatja mesatare e një interviste në hulumtimin ka qenë 30 minuta ndërsa, intervista është analizuar me teknikën e analizës përmbajtësore. Pyetësi është përpiluar nga ekipi hulumtues, dhe përbëhet nga 14 pyetje gjysmë të hapura dhe të hapura. Pyetësi është testuar në një grup pilotues, me qëllim të sigurimit të vlefshmërisë së brendshme, të jashtme dhe besueshmërisë së të dhënave të mbledhura. Koeficienti i besueshmërisë së njësisë të pyetësit është .80.

### Mostra

Përcaktimi i mostrës është bërë në mënyrë të qëllimshme, ku ekipi hulumtues është bazuar në të dhënat ekzistuese të DKA-ve, mbi institucionet shkollore në të cilat vijohet mësimi nga fëmijët me nevoja të veçanta. Më pas, ekipi hulumtues ka kontaktuar dhe vizituar shkollat përkatëse për të konfirmuar pjesëmarrësit dhe lejet prindërore, dhe për të intervistuar fëmijët. Në total janë intervistuar 210 nxënës me nevoja të veçanta të klasëve 6-9, nga 50 shkolla fillore, në shtatë (7) komunit kryesore në Kosovë. Moshë mesatare e mostrës është 13.4 vjeç, me 40.48% vajza dhe 59.52% djem. Mostra është përbërë nga fëmijë me diagnoza të ndryshme, të cilat mund të kategorizohen në këto kategori: Ngecje Intelektuale me 18.1%, Autizëm 3.5%, Dëmtime Fizike: 72%, Down Syndrome 2.4% dhe ADHD 4%.

● Në total janë intervistuar 210 nxënës me nevoja të veçanta të klasëve 6-9, nga 50 shkolla fillore, në shtatë (7) komunit kryesore në Kosovë. Moshë mesatare e mostrës është 13.4 vjeç, me 40.48% vajza dhe 59.52% djem.

**të gjeturat  
kryesore**



## Të gjeturat kryesore

Projekti “Mos supozo nevojat e mia” përfshinë disa faza të hulumtimit të nevojave të fëmijëve me nevoja të veçanta në procesin mësimor. Të dhënat e paraqitura në këtë raport janë nxjerrë nga hulumtimi në terren, nga fokus grupet e organizuara me hisedarë, si dhe diskutimet e organizuara me fëmijë me nevoja të veçanta dhe zhvillim tipik. Nga këto takime janë arritur të identifikohen shtatë (7) nevoja kryesore të fëmijëve me nevoja të veçanta në procesin mësimor:

### 1. Nevoja për përfshirje dhe mbështetje në procesin mësimor

Si pjesë e përditshmërisë mësimore paraqitet si problem mos-përfshirja në proces, gjersa 65% nxënësit gjatë intervistimit kanë shprehur që shumë shpesh nuk merren parasysh nga ana e mësimitdhënësve. Sipas diskutimeve kjo çështje nuk rrjedhë nga mos-dëshira apo mos-vullneti i mësimitdhënësve të i dalin në ndihmë fëmijëve që shprehin apo ndaj të cilëve vërehet nevoja për mbështetje, por numri i madh i nxënësve në klasë është faktor penalizues.

### 2. Nevoja për përdorim të metodave konkrete gjatë orës mësimore

57% e fëmijëve janë shprehur që nuk i kuptojnë formulat në lëndën e matematikës, e kanë të vështirë t'i kuptojnë proceset e fizikës dhe nuk i kuptojnë shumë mirë proceset në lëndën e biologjisë. Këto deklaramete të fëmijëve me nevoja të veçanta të intervistuar na bëjnë të nënkuptojmë që për t'i lehtësuar procesin e mësim-nxënies, brenda një ore mësimore sidomos në shkencë ekzakte apo lëndë shkencore mësimitdhënësit duhet të përdorin teknika më konkrete dhe në rast të mungesës së tyre në shkollë, do të duhej të përdorehin materiale improvizuese.

### 3. Nevoja për shoqëri

Hulumtimi në terren, e ka nxjerrur në pah që 57% të fëmijëve me nevoja të veçanta nga 210 sa janë intervistuar janë shprehur që pjesën e pushimeve në shkollë e kalojnë të vetmuar. Një rezultat i tillë është edhe më shqetësues për faktin që gjatë procesit të intervistimit është vërejtur nga hulumtuesit që fëmijët me nevoja të veçanta janë më të tërhequr dhe kryesisht kalojnë kohë vetëm.

Hulumtimi në terren, e ka nxjerrur në pah që 57% të fëmijëve me nevoja të veçanta nga 210 sa janë intervistuar janë shprehur që pjesën e pushimeve në shkollë e kalojnë të vetmuar.

#### 4. Nevoja për aktivitete jashtë-shkollore dhe lëndë kulturore si Art Figurativ dhe Muzikor

Fëmijët në përgjithësi janë vetëm pjesëmarrës të procesit mësimor në klasë, dhe kanë dukshmërisht mungesë të aktiviteteve jashtë-shkollore e jashtë-kurrikulare. Mungesa e tillë, sidomos vërehet tek fëmijët me nevoja të veçanta, të cilët nuk janë aspak të përfshirë në aktivitete të tilla. Të gjithë fëmijët (100% të fëmijëve të intervistuar) janë shprehur që nuk janë pjesë e aktiviteteve jashtë-shkollore.

#### 5. Nevoja për mësimdhënës/e mbështetës/e

Është vërejtur që vetëm në disa raste ka pasur mësimdhënës/e mbështetës/e në klasa me pjesëmarrje të fëmijëve me nevoja të veçanta. Mësimdhënësit mbështetës ishin kryesisht prezent në raste të diagnostikimeve me ngecje të dyfishta: mentale dhe fizike të fëmijëve pjesëmarrës në klasë.

#### 6. Nevoja për diagnostikim të saktë

Të dhënat e nxjerra nga hulumtimi tregojnë që mungesa e diagnostikimit të saktë, mungesa e profesionistëve adekuat dhe mungesa e instrumenteve adekuate është shumë e evidente. Rreth 65% të fëmijëve në mostrën tonë janë paraqitur si të diagnostikuar me spektër të autizmit sipas informacioneve të mësimdhënësve dhe drejtorëve/eve të shkollave të përzgjedhura në hulumtim. Mirëpo, hulumtuesit me sfond/kualifikim psikologjik kanë vërejtur që rreth 30% të fëmijëve nuk i kanë shfaqur simptomat tipike të autizmit.

#### 7. Nevoja për infrastrukturë të përshtatshme

Shkollat fillore kanë mungesë të infrastrukturës adekuate për fëmijët me nevoja të veçanta nisur nga cilësia e objektit të shkollës, vjetërsia dhe plani, shkallët brenda objekteve shkollore penalizojnë qasjen e fëmijëve me nevoja fizike, ku në raste të caktuara ato janë të ngushta, të rrëshqitshme dhe të pa përshtatshme për fëmijë qoftë me nevoja të veçanta apo dhe me zhvillim tipik.

● Si pjesë e përditshmërisë mësimore paraqitet si problem mos-përfshirja në proces, gjersa 65% nxënësit gjatë intervistimit kanë shprehur që shumë shpesh nuk merren parasysh nga ana e mësimdhënësve

**rezultatet**



## Rezultatet

Të dhënat e mbledhura janë analizuar me metodën cilësore të analizës së bisedës. Andaj rezultatet e poshtëshënuara përshkruajnë nevojat e fëmijëve me nevoja të veçanta në arsimin fillor në aspekt cilësor. Rezultatet e përgjithshme kanë qenë të mundura të numerizohen vetëm në aspektin e paraqitjes së numrit të nxënësve që kanë shprehur nevojën e tillë. Përderisa, përshkrimi i variablave është i natyës së analizës së bisedës. Analiza e bisedës ka ngërthyer analizën e informacionit të dhënë dhe interpretimin e të dhënave. Kjo është njëra ndër analizat më të përshtatshme për të vlerësuar informacione të tilla, duke u bazuar në mundësinë e shprehjes së fëmijëve me nevoja të veçanta. Pyetësi është përbërë nga pyetje të përshtatshme për të diskutuar më fëmijët; andaj parashtrimi i pyetjeve ka qenë i natyrës së hapur dhe gjysmë të hapur.

Variablat e pyetësorit kanë rezultuar në identifikimin e shtatë (7) nevojave të fëmijëve me nevoja të veçanta:

65% e fëmijëve kanë shprehur që nuk ndjenjë kënaqësi në lëndët në të cilat kërkohet nga ana e mësimitdhënësve që fëmijët me nevoja të veçanta të jenë të qetë.

### 1. Nevoja për përfshirje dhe mbështetje në procesin mësimor

Përfshirja në domosdoshmëri është akt i akomodimit të fëmijëve që ndjehen të përjashtuar qoftë ajo për shkak të etnisë, gjinisë, racës, religjionit, identitetit apo aftësisë. Përgjithësisht, në historik të gjërë informacioni dhe përvojave në terren, sistemi arsimor i Kosovës pa marrë parasysh këmbënguljes për të ofruar kushte për të gjithë, në rutinën shkollore shpesh ka krijuar pa-përshtatëshmëri gjithëpërfshirje nisur nën nuanca diskriminuuese.

Sipas këtij hulumtimi, si pjesë e përditshmërisë mësimore paraqitet si problem mos-përfshirja në proces, gjersa nxënësit gjatë intervistimit kanë shprehur që shumë shpesh nuk merren parasysh nga ana e mësimitdhënësve. Këtë, fëmijët e kanë shprehur duke dhënë informacion të përfshirjes në lëndë të ndryshme ku 65% e fëmijëve kanë shprehur që nuk ndjenjë kënaqësi në lëndët në të cilat kërkohet nga ana e mësimitdhënësve që fëmijët me nevoja të veçanta të jenë të qetë.

Gjatë intervistimit fëmijët kanë qenë të koncentruar në dhënien e informatës në lidhje me preferencat e tyre ndaj lëndëve të ndryshme



arsimore, ku ata ndejnë më shumë apo më pak kënaqësi. Në këtë rast, hulumtimi tregon që fëmijët me nevoja të veçanta nuk i preferojnë shkencat natyrore. Nëse krahasojmë këtë përgjigje me diagnozën të cilën ata e kanë, jo domosdoshmërisht ka ndërlidhje në mes të diangzonës dhe predispozitës për lëndët. Por, ky mos interesim për shkencat natyrore është i shprehur tek të gjithë pjesëtarët e hulumtimit; gjë që na bën të kuptojmë që mos angazhimi i tyre në orët ku mësohen lëndët shkencore i bënë ata të humbin interesimin.

Në përgjithësi, fëmijët kanë shprehur se ndjenjë më shumë kënaqësi dhe që ndjehen më të përfshirë në orët kur mësohen lëndët e artit figurativ dhe atë të artit muzikor.

Pa asnjë dyshim, arti figurativ dhe muzika ofrojnë mundësi për të mësuar shkathtësi të cilat po-ashtu mund të transferohen në lëndët tjera; mirëpo, është shumë e nevojshme që fëmijët të ndjehen pjesë edhe e lëndëve të natyrore.

Për të përmbushur hulumtimin për saktësim të secilës nevojë, organizata Këshilli Rinor Kosovar ka organizuar dhe diskutime të hapura me fëmijë me nevoja të veçanta dhe me ata me zhvillim tipik, pjesëmarrës nga 50 shkolla fillore nga shtatë (7) regjionet e mëdha.

Në këtë rast, me përpikmëri diskutimi në të gjitha debatet e mbajtura, u potencua nga fëmijët që kanë shumë nevojë për mbështetje më të madhe mësimore. Mirëpo, sipas diskutimeve kjo çështje nuk rrjedhë nga mos-dëshira apo mos-vullneti i mësimdhënësve të i dalin në ndihmë fëmijëve që shprehin apo ndaj të cilëve vërehet nevoja për mbështetje, por numri i madh i nxënësve në klasë është faktor penalizues. Përkundër faktit që mësimdhënësit ndonjëherë organizojnë aktivitete ku nxënësit angazhohen të ndarë në grupe punuese brenda orës mësimore, është e pamundur për një mësimdhënës/e që t'i japë vëmendje të veçantë secilit fëmijë. Kjo si rrjedhojë, ndikon që disa nga fëmijët që janë më të tërhequr të mos ndihen të përfshirë tërësisht në të gjitha pikat e programit të një orë mësimore. Ky problem, është edhe më i potencuar në rastet e fëmijëve me nevoja të veçanta në mungesë të mësimdhënësit/es mbështetës/se.

Përveç kësaj, disa nga nxënësit kanë pranuar që mësimdhënësit

ndonjëherë preferojnë disa fëmijë në relacion me fëmijë të tjerë, ngaqë sipas fëmijëve të intervistuar sjelljet e mësimdhënësve dallojnë dhe variojnë nga një fëmijë tek tjetëri. Si dhe, fëmijët konsiderojnë që qasja e mësimdhënësve ndaj disa fëmijëve është diskriminuese. Sipas tyre, mësimdhënësit shpesh përdorin edhe gjuhë të urrejtjes ndaj tyre, duke thëlluar kështu distancimin në relacionin nxënës-mësimdhënës. Prandaj, në të shumtën e rasteve kur ndonjë fëmijë shpreh nevojë për mbështetje apo kërkon ndihmë për t'i kuptuar informatat rreth një mësimi, apo për të përfunduar ndonjë detyrë lëndore, janë shokët dhe shoqet ata që u vihen në ndihmë.

Shembuj nga diskutimet me fëmijë në debatet e organizuara:

- “Zakonisht këta arsimtarë/re janë në moshë më të shtyrë, dhe për arsye se janë zhvilluar në kohë kur edhe dhuna fizike ndaj nxënësve nuk është parë aq problem sa është sot, ne mundohemi të i kuptojmë” – Nxënësi/ja A, në debatin e organizuar në komunën e Gjakovës.

- “Arsimtari nuk i don krejt nxënësit njejtë. Qysh fol me secilin dhe qysh sillet me nxënësit nuk është e njejtë – ndonjëherë është më agresiv. Ka ndodhë që ka qenë më agresiv, nxënësi ka bo pyetje dhe i ka thënë pse i ka penguar dhe nuk i ka ndihmu me përgjigje.” – Nxënësi/ja B, në debatin e organizuar në komunën e Prishtinës.

- “Ka ndodhë shumë që shokët i kanë ndihmu dhe jo arsimtari.” – Nxënësi/ja C, në debatin e organizuar në komunën e Prishtinës.

## **2. Nevoja për përdorim të metodave konkrete gjatë orës mësimore**

Metodat konkretizuese duke përdorur materiale didaktike, materiale kreative dhe improvizuese e lehtësojnë dukshëm procesin mësimor të nivelit 1 dhe 2 të Standardeve Ndërkombëtare të Klasifikimit të Arsimit - ISCED. Jo vetëm fëmijët me nevoja të veçanta ballafaqohen me sfida në mësim-nxënie për shkak të metodologjisë të papërditësuar në mësimdhënie dhe mungesës së materialeve konkrete mësimore. Kur themi

materiale konkrete i referohemi të gjitha materialeve dhe objekteve konkrete që mund të shihen, mund të preken dhe të ndjehen. Për shembull, nëse tentohet të u mësohet fëmijëve në lëndën e matematikës për katërkëndëshin, për t'a kuptuar konkretisht një fëmijë informatën dhe funksionin e tij ai do të kishte qenë mirë të shihte ndonjë video, ndonjë ekzemplarë prej letre ose dhe ta ndërtonte vet një të tillë.

Në rastin e hulumtimit, 57% të fëmijëve kanë shprehur që nuk i kuptojnë formulat në lëndën e matematikës; e kanë shumë të vështirë t'i bëjnë kalkulimet në detyrat e matematikës; e kanë të vështirë t'i bëjnë kalkulimet në detyrat e matematikës; e kanë të vështirë t'i bëjnë kalkulimet në detyrat e matematikës; e kanë të vështirë t'i kuptojnë proceset e fizikës dhe nuk i kuptojnë shumë mirë proceset në lëndën e biologjisë. Këto deklaramë të fëmijëve me nevoja të veçanta të intervistuar na bëjnë të nënkuptojmë që për t'i lehtësuar procesin e mësim-nxënies, brenda një ore mësimore sidomos në shkencë ekzakte apo lëndë shkencore mësimdhënësit duhet të përdorin teknika më konkrete dhe në rast të mungesës së tyre në shkollë, do të duhej të përdorehin materiale improvizuese. Nëse i kthehemi sërish shembullit të katërkëndëshit ai lehtë mund të improvizohet duke përdorur karton e letër.

Shembuj nga intervistimi i fëmijëve me nevoja të veçanta

## **Pyetja “Cila lëndë të pëlqen më së paku? Cka nuk të pëlqen në atë lëndë ?”**

**“Matematika nuk më shkon”  
- vajzë, 14 vjeçare, klasa e 6**

**“Nuk di të mbledh e zbres”  
- djalë 15 vjeçar, klasa 9”**

● 57% të fëmijëve kanë shprehur që nuk i kuptojnë formulat në lëndën e matematikës; e kanë shumë të vështirë t'i bëjnë kalkulimet në detyrat e matematikës; e kanë të vështirë t'i bëjnë kalkulimet në detyrat e matematikës; e kanë të vështirë t'i kuptojnë proceset e fizikës dhe nuk i kuptojnë shumë mirë proceset në lëndën e biologjisë.

## **“Nuk më pëlqen biologjia, nuk kuptoj” - djalë 13 vjeçar, klasa 6.**

Nga kjo mund të vërehet që fëmijët kanë nevojë që gjatë orës së mësimi të aplikohen metoda më konkrete dhe të përdoren mjete konkretizuese për shpjegim; posaçërisht në lëndët: matematikë; fizikë dhe biologji. Mjetet konkretizuese dhe metodat e konkretizimit duhet të definojnë nga bartësit të lëndëve përkatëse dhe të adaptohen për grupmoshat përkatëse.

Duhet të kemi parasysh, që niveli i vështirësisë së të kuptuarit ndërlidhet me nevojën e veçantë dhe diagnozën. Mirëpo, ky hulumtim ka reflektuar në përgjithësi këtë vështirësi, pavarësisht nevojës së veçantë të fëmijës. Aplikimi i mjeteve konkretizuese për mësim-dhënie është i domosdoshëm për të zhvilluar parafytyrimin, kujtesën dhe për të ngritur mundësinë që fëmijët me nevoja të veçanta të nxënë më shumë njohuri dhe të mësojnë shkathtësi të reja. Mësim-dhënia teorike e ul edhe më tutje interesimin ndaj lëndës, gjë që e dëmton dukshëm zhvillimin e fëmijëve me nevoja të veçanta.

Ndërkaq, gjetjeve përpos intervistimit i kanë kontribuar dhe diskutimet me fëmijë me nevoja të veçanta dhe ata me zhvillim tipik ku ndër të tjera përgjithësisht një shumicë e pjesëmarrësve në debatet e organizuara janë shprehur që mjetet e punës në klasa janë në mungesë të madhe, mjete nga ato më thelbësore si fleta të bardha, fleta me ngjyra, lapsa me ngjyra, kube dhe mjete të tjera kreative për numërim, mjete teknologjike si projektor për të projektuar video dhe materiale të tjera vizuale por dhe për përdorim të tij gjatë organizimit të aktiviteteve jashtë-kurrikulare. Në disa raste, këto mjete mundësohen nga mësimdhënësit apo krijohen vetë nga fëmijët varësisht nevojës, përkundër faktit pajisja e shkollave me mjete të tilla është detyrë dhe kompetencë, fillimisht e Komunave përkatëse nën qeverisje lokale, saktësisht Drejtorive Komonale të Arsimit, që t'i pajisin të gjitha shkollat me mjetet e nevojshme konkrete mësimore, dhe së dyti e stafit drejtues të shkollës. Në raste të tjera, në kabinetet e mbushura me mjete përdoruese në relacion me lëndën mësimore (kabineti i Kimisë

dhe Fizikës), nxënësit nuk lejohen të përdorin mjetet e nevojshme për të zhvilluar mësimin praktik, mbi bazën që do të i dëmtojnë, përkundër faktit që mësimdhënësit janë prezent përgjatë orëve mësimore. Kjo dukuri, është e potencuar vazhdimisht edhe në terren por sidomos në këto diskutime të gjithë nxënësit u shprehën që kanë nevojë për mësim praktik, dhe jo vetëm për atë teorik. Kjo nevojë sipas pjesëmarrësve është adresuar vazhdimisht tek drejtoritë e shkollave, mirëpo nuk ka pasur përmirësime të situatës.

Shembull nga diskutimet me fëmijë në debatet e organizuara:

“Mungojnë disa pajisje për me bo klasën ma kreative, por nxënësit i bojnë vet.”- nxënësi D, nga debati në komunën e Mitrovicës.

### **3. Nevoja për shoqëri**

Angazhimi social është një prej faktorëve që ndikon sjelljet e fëmijëve me nevoja të veçanta dhe që shpalosen qysh në fëmijëri të hershme dhe i ndjekin deri në adoleshencë. Termi social i referohet interkasionit apo relacionit që mund të krijohet në mes të dy personave në këtë rast fëmijëve të cilët i përgjigjen njëri-tjetrit dhe i ndikojnë sjelljet e njërit-tjetrit. Prandaj, socializimi është shumë i rëndësishëm për moshën e fëmijëve të cilët janë intervistuar duke qenë se kështu ata krijojnë bindje, siguri dhe në të njëjtën kohë i zbulojnë karakteristikat e personalitetit të vet.

Hulumtimi në terren, e ka nxjerrur në pah që 57% të fëmijëve me nevoja të veçanta nga 210 sa janë intervistuar janë shprehur që pjesën e pushimeve në shkollë e kalojnë të vetmuar. Një rezultat i tillë është edhe më shqetësues për faktin që gjatë procesit të intervistimit është vërejtur nga hulumtuesit që fëmijët me nevoja të veçanta janë më të tërhequr dhe kryesisht kalojnë kohë vetëm.

Shembuj të përgjigjeve nga intervistimi i fëmijëve me nevoja të veçanta

## **Pyetja: “Si e kaloni pushimin e gjatë?”**

**“..Rri vetëm”-**

**- vajzë, 11 vjeçare, klasa 7;**

**“Rri vetëm në klasë”**

**- vajzë, 11 vjeçare, klasa 6;**

**“Shkoj dhe i laj sytë”**

**- djalë, 14 vjeçar, klasa 8.**

Shoqërimi është shumë i rëndësishëm për të gjithë fëmijët, e në veçanti për fëmijët me nevoja të veçanta. Të mësuarit e shkathtësive sociale duhet të ndodhë përkrah të të nxëniet të njohurive dhe të mësuarit e shkathtësive teknike. Andaj, duhet të krijohen mekanizma në kuadër të insitucioneve shkollore për inkuadrimit social të fëmijëve me nevoja të veçanta. Ngritja e nivelit të inkuadrimit social do të ul nivelin e paragjykimeve potenciale ndaj fëmijëve me nevoja të veçanta. Institucionet shkollore duhet të krijojnë programe dhe aktivitete grupore për të gjithë fëmijët në kuadër të procesit mësimor; të cilat do t'a nxisnin socializimin e fëmijëve në përgjithësi dhe fëmijëve me nevoja të veçanta në veçanti.

Poashtu, kjo nevojë është konsideruar si një ndër më të rëndësishmet nga fëmijët në të gjitha debatet e organizuara. Në çdo debat, është diskutuar në tërësi që ka shumë fëmijë që kalojnë kohë të vetmuar, dhe ndihen të lënë anash në aktivitete mësimore. Edhe pse, lehtësimi i këtij procesi socializues nga mësime mësimor është shumë i nevojshëm, ndihma e ofruar nga ta nuk është gjithmonë prezente. Mirëpo, sipas deklarimeve të fëmijëve në diskutim, janë fëmijët e tjerë kryesisht ata me zhvillim tipik që u qasen dhe u ofrojnë ndihmë fëmijëve me nevoja të veçanta duke i ftuar të

kalojnë kohë së bashku apo edhe të mësojnë së bashku. Nxënësit e të gjitha shkollave, prezent në debatet e organizuara nga Këshilli Rinor Kosovar kanë pranuar se kanë të paktën një nxënës në klasë të tyre që kalon kohën vet.

Ka vetëm disa raste të potencuara që mësimdhënësit i kontribuojnë këtij procesi duke i ulur nxënësit në një bankë me njëri-tjetrin. Në anën tjetër, diskutimet tregojnë që në raste të tjera, mësimdhënësit përkundër veprimit të parë, në rastet kur konsiderojnë që një fëmijë ka shkelur disiplinën, si formë ndëshikimi ulin fëmijën vet në bankë për një kohë të gjatë.

Shembuj nga diskutimet me fëmijë në debatet e organizuara:

- “Ka fëmijë që rrijnë vet, shumë prej tyre nuk bisedojnë me askënd, edhe për detyra ju kanë ndihmuar por jo me sukses i kanë përfunduar detyrat.” – Nxënësi E, në debatin e organizuar në komunën e Prishtinës.

- “Ka qenë një shok që ka nejtë gjithmonë vet po i kam ndihmu dhe është bërë shok me neve.”- Nxënësi/ja F, në debatin e organizuar në komunën e Prishtinës.

- “E lojnë gjithë vet, e ngucin, e lojnë m’u ulë vet.”- Nxënësi/ja G, në debatin e organizuar në komunën e Prizrenit.

- “Nxënësit që janë ma t’vetmum, nuk kanë shumë sukses n’landë mësimore, edhe i qortojnë ma shumë, edhe ka raste që i injorojnë.”- Nxënësi/ja H, në debatin e organizuar në komunën e Ferizajit.

#### **4. Nevoja për aktivitete jashtë-shkollore dhe lëndë kulturore si Art Figurativ dhe Muzikor**

Aktivitetet jashtë-shkollore brenda sistemit të arsimit para-universitar në vendin tonë rregullohen sipas Udhëzimit Administrativ Nr.02/2016 për Aktivitetet Jashtëshkollore (në vazhdim **“UA për Aktivitetet Jashtëshkollore”**)<sup>7</sup> i cili përcakton llojet e ndryshme të aktiviteteve

<sup>7</sup> Udhëzimi Administrativ Nr.02/2016 për Aktivitetet Jashtëshkollore, Republika e Kosovës, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, 2016

jashtëshkollore që një shkollë mund t'i realizoj siç janë vizitat në muze, parqe e natyrë; festim të datave të veçanta, ngjarjeve e traditave; pjesëmarrjes së nxënësve në procese vendim-marrëse në shkollë; aktivitete të lira si arte të bukura, fotografi, ese e të tjera; shërbime për bashkësinë (ndihmë për ata që kanë nevojë); promovim të shëndetit dhe mbrojtje të mjedisit si dhe shëtitje e pikniqe. Ndërkaq, sipas këtij hulumtimi të zhvilluar në terren, fëmijët në përgjithësi janë vetëm pjesëmarrës të procesit mësimor në klasë, dhe kanë dukshmërisht mungesë të aktiviteteve jashtë-shkollore e jashtë-kurrikulare. Mungesa e tillë, sidomos vërehet edhe më shumë tek fëmijët me nevoja të veçanta, të cilët nuk janë aspak të përfshirë në aktivitete të tilla. Kur janë pyetur gjatë intervistimit të gjithë fëmijët (100% të fëmijëve të intervistuar) janë shprehur që nuk janë pjesë e aktiviteteve jashtë-shkollore.

Hulumtimi tregon që të gjithë fëmijët si aktivitet jashtë procesit mësimor kryesisht luajnë në shtëpi, me familjar dhe shoqëri të lagjes. Angazhimi në aktivitete po sipas tyre iniciohet vetëm nga ana

e familjes. Në anën tjetër duhet potencuar që roli i familjes është i rëndësishëm mirëpo, nuk mund të mbetet i vetmi faktor në zhvillimin intelektual dhe social të fëmijëve, kundruall rolit të aktiviteteve jashtë-shkollore që mundësojnë zhvillim të shkathtësive sociale, analitike si dhe shërbejnë si model për komunikim. Këto shkathtësi do të mbështesin zhvillimin e më tutjemë të fëmijëve dhe do të mund të transferoheshin në zhvillimin e tyre kognitiv.

Sipas nenit 23 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar i cili përcakton që Drejtori i shkollës apo Këshilli i Prindërve të shkollës me pëlqim të Këshillit Drejtues të Shkollës mund të organizojnë aktivitete jashtë-shkollore për nxënësit e shkollave. Është shumë e rëndësishme që organizimi i këtyre aktiviteteve të sigurojë pjesëmarrje të barabartë të të gjithë fëmijëve me nevoja të veçanta dhe të atyre me zhvillim tipik por dhe fëmijëve që u takojnë grupeve të marginalizuara. Në këtë mënyrë do të mbështetet zhvillimi i shkathtësive analitike, sociale dhe komunikuese të fëmijëve.

Në vazhdimësi për të vërtetuar nevojën për momente më pak stresuese e lëndore, hulumtimi ka matur dhe kënaqësinë e fëmijëve karshi lëndëve që

<https://masht.rks-gov.net/uploads/2016/01/ua-masht-nr-02-2016-per-aktivitetet-jashteshkoll-lore-rotated.pdf>

●  
Hulumtimi ka matur dhe kënaqësinë e fëmijëve karshi lëndëve që janë më atraktive ku 95% e tyre janë shprehur që ndjejnë shumë kënaqësi gjatë orës së Artit Figurativ dhe atë të Muzikës. Kjo, sepse ata konsiderojnë që gjatë këtyre orëve mësimore ndjehen më të lirë.



janë më atraktive ku 95% e tyre janë shprehur që ndjejnë shumë kënaqësi gjatë orës së Artit Figurativ dhe atë të Muzikës. Kjo, sepse ata konsiderojnë që gjatë këtyre orëve mësimore ndjehen më të lirë.

Arti dhe muzika kanë rol të rëndësishëm në zhvillimin e fëmijëve në përgjithësi dhe kjo vërtetohet edhe në bazë të përgjigjeve të fëmijëve të mostrës së këtij hulumtimi të cilët kanë shprehur një qasje shumë pozitive ndaj këtyre dy lëndëve prandaj dhe vlen të potencohet si një sferë për t'u zhvilluar edhe me tutje. Institucionet shkollore duhet të krijojnë hapësira dhe programe më të avancuara për fëmijët që ndjekin mësim në shkollë në fushën e artit figurativ dhe atë të muzikës. Përveç orëve të rregullta sipas planprogramit dhe kurrikulës lëndore, sugjerohet që lënda e artit figurativ dhe atij muzikor të ofrohet edhe përmes mësimi zgjedhor apo orëve jashtë-kurrikulare nëpërmjet organizimit të aktiviteteve e programeve gjithëpërfshirëse. Në rast se shkollat nuk kanë infrastrukturë të përshtatshme për të krijuar organizime të tilla, apo hapësirë të tillë, atëherë, rekomandohet që të përfshihen edhe institucionet komunale, duke ofruar hapësira të tjera adekuata si qendrat rinore, bibliotekat apo sallat teatrale dhe koncentrale në mënyrë që të ofrohet mbështetje dhe disponim bashkëpunues i të gjithë hisedarëve qoftë institucioneve shkollore, komunale si dhe organizatave jo fitim-prurëse që mund të ofrojnë aktivitetet të tillë lehtësues për mësim-nxënie.

Ndërkaq organizimi i debateve dhe diskutimit me nxënës me aftësi të veçanta dhe ata me zhvillim tipik, e ka ofruar perspektivën e fëmijëve edhe më të gjerë karshi aktiviteteve jashtë-shkollore ku, të gjithë fëmijët janë shprehur se kanë nevojë për të tilla aktivitete, madje në raste e shohin si mëse të nevojshme për t'u shoqëruar me njëri-tjetrin. Më specifikisht, sipas fëmijëve mendohet që aktivitetet jashtë-shkollore janë forma më e mirë që fëmijët pak më të tërhequr të kanë mundësi të përfshihen në grupe shoqërore dhe kështu të socializohen. Dosido, diskutimi me nxënës ka orientuar Këshillin Rinor Kosovar edhe në përforcim të informatës karshi aktiviteteve ekzistene. Në këtë rast, është kuptuar që nga shkolla fillore në lokacione të ndryshme të Kosovës, nxënësit kanë funksionalizuar Klube të ndryshme në fusha apo tema siç janë: Klubi i Ndërmjetësimi, Klubi i

Ekologëve, ai i Kimistëve, i Sportistëve, i Artit, i Gazetarëve, apo në disa raste ndonjë shkollë posedon dhësi dhe radio të shkollës që përdoret kryesisht nga nxënësit varësisht aktivitetit që ata përzgjedhin ta paraqesin. Sidoqoftë, dhe kur këto klube janë aktive, jo të gjithë fëmijët marrin pjesë qoftë brenda strukturimit të klubeve apo aktiviteteve që zhvillohen nën kuadër të tyre. Në të shumtën e rasteve janë nxënësit e njejtë ata që përfitojnë nga ky aktivitet nga pjesëmarrja në to përderisa konsiderohet që ka mungesë të motivimit dhe mungesë të nxitjes gjithëpërfshirëse nga ana e mësimeve të tyre që përcjellin apo fasilitojnë punën e këtyre klubeve të nxënësve.

Përveç aktiviteteve jashtë-shkollore me nxënësit pjesëmarrës në diskutime është diskutuar dhe preferenca e tyre karshi lëndëve të ndryshme. Në këtë rast, fëmijët me zhvillim tipik, një shumicë e madhe janë deklaruar që u pëlqejnë më shumë lëndët si: gjeografia, matematika dhe biologjia, ndërsa shumica e fëmijëve me nevoja të veçanta kanë shprehur preferencë më të madhe për muzikën, gjuhën shqipe/angleze, apo artin figurativ, për arsye që nuk kërkohet shumë nga ta dhe ndihen të lirë të shprehin veten pa presion. Disa nga fëmijët me nevoja të veçanta kanë shprehur se u pëlqen muzika për arsye se është shumë relaksuese. Shembuj nga diskutimet me fëmijë në debatet e organizuara:

- S'kemi aktivitete ku nuk ka duhet me bo dicka, ama kish qenë shumë mirë me pasë. Një herë e kemi kqyr ni film me mesazh, edhe kanë ardhë krejtë fëmijët edhe ata ma të ndrojtun, edhe hala e kemi vazhdu shoqërinë masnej - Nxënësi/ja K, në debatin e organizuar në komunën e Ferizajit.

- "Kemi grupe të shumta të ndryshme, një dite kundër varfërisë mbledhim ushqime dhe i shpërndajmë ato." - Nxënësi/ja L, në debatin e organizuar në komunën e Prishtinës.

- "Klubi i ndërmjetësimit, sistemi i ndërmjetësimit ku cdo klase ka nga një delegat që e lajmëron rastin në klub, dhe ka mundësuar që mos të ketë konflikte. Ka psikologun e shkollës dhe arsimtaren e trajnuar për klubin e ndërmjetësimit. Problemet gjithmonë me sukses kanë rezultu nga grupi i

ndërmjetësimit.” – Nxënësi/ja M, në debatin e organizuar në komunën e Prishtinës.

- “Po ka aktivitete brenda shkollës, ama duhet m’u inkuadru nxënës të ndryshëm, gjithë të njëjtit marrin pjesë, duhet m’i përfshi ma shumë nxënës.” – Nxënësi/ja N, në debatin e organizuar në komunën e Ferizajit.

## **5. Nevoja për mësimdhënës/e mbështetës/e**

Parimi gjithëpërfshirës brenda sistemit të arsimit të Kosovës rregullohet përveç të tjerash sipas nenit 40 paragrafit 2.1 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar i cili përcakton se institucionet arsimore dhe aftësuese duhet të akomodojnë të gjithë fëmijët, pa dallim të kushteve të tyre fizike, intelektuale, sociale, gjuhësore apo të tjera dhe duhet të promovojë integrimin dhe kontaktin mes fëmijëve, ndryshe paragrafi 2.2 i të njëjtit nen përcakton që mbështetja përkatëse duhet të ofrohet bazuar në nevojat intelektuale të nxënësve.

Ndërkaq, sipas nenit 37, paragrafit 1 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar përcaktohet se personat e kualifikuar sipas standardeve të specifikuara në një akt nënligjor mund të zgjidhen nga komuna në institucionet arsimore për të ofruar shërbime profesionale, përfshirë: kujdesin mjekësor, mbështetjen pedagogjike-psikologjike, si dhe punë këshilluese dhe sociale.

Në anën tjetër, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka konsideruar sistemin e arsimit të vendit tonë si sistem të segreguar, për shkak të klasave të bashkëngjitura dhe për këtë arsye kanë vendosur të ndërtojnë sistem të mbështetjes për fëmijët me nevoja të veçanta në atë formë që fëmijët të jenë sa më tepër që është e mundshme në shkolla dhe klasa të rregullta dhe të marrin mbështetjen në ato klasa, pa pasur nevojë që të ndahen. Njëra formë e mbështetjes është ndihma me anë të mësimdhënësve udhëtues të Qendrave Burimore (ish shkollat speciale) që të mbështesin fëmijët dhe mësimdhënësit e tyre në shkolla të rregullta. Forma tjetër është punësimi i mësimdhënësve gjithëpërfshirës të cilët do të

punësohen në shkolla të rregullta dhe të cilët janë të trajnuar për të punuar me fëmijët me nevoja të veçanta.<sup>8</sup> Gjithashtu, sipas nenit 3 - paragrafit 1 të Udhëzimit Administrativ 24/2014 Shndërimi i Klasave të Bashkëngjitura në Dhoma Burimore<sup>9</sup> (në vazhdim “UA për Shndërim të Klasave të Bashkëngjitura në Dhoma Burimore”), pas përfundimit të procesit të shndërrimit të Klasës të bashkëngjitur (KB) në Dhomën e Burimeve (DHB), mësimdhënësi i klasës së bashkëngjitur kalon si mësimdhënësi i klasës mbështetës në nivel shkollë. Gjatë hulumtimit në terren nga hulumtuesit është vërejtur që vetëm në disa raste ka pasur mësimdhënësi mbështetës në klasa me pjesëmarrje të fëmijëve me nevoja të veçanta. Mësimdhënësit mbështetës ishin kryesisht prezent në raste të diagnostikimeve me ngecje të dyfishta: mentale dhe fizike. Andaj, kjo mungesë e vërejtur reflekton nevojën për të pasur numër më të madh të mësimdhënësve mbështetës po aq mos-zabtimin e legjislacionit në fuqi karshi nevojës së paraqitur meqë secila klasë nga ato që janë monitoruar në kuadër të hulumtimit, me përmbajtje pjesëmarrëse të fëmijëve me nevoja të veçanta tregojnë që fëmijët kanë vështësi në të nxënë rrjedhimisht u duhet mbështetje qoftë në organizim të klasës, punë individuale, plan individual, këshillim si dhe materiale mësimore shtesë. Të gjitha këto sipas nenit 5 të UA për Shndërim të Klasave të Bashkëngjitura në Dhoma Burimore hynë nën kompetencë të rolit të mësimdhënësit/es mbështetës/e .

Fëmijët ndër të tjera janë shprehur që mësimdhënësit klasor ju shpjegojnë materialin mësimor vazhdimisht dhe në mënyrë të persëritshme nëse informatat janë të paqarta, në bazë të kërkesës së tyre por në raste të tjera shokët dhe shoqet e klasës ju dalin në ndihmë. Në përgjithësi kjo lë të nënkuptojë që ka bashkëpunim të ndërsjelltë në mes të nxënësve dhe mund të mësimdhënësve por kjo ndihmë nuk është e mjaftueshme në lehtësim të të nxënësve. Përveç të tjerash, mungesa e mësimdhënësve mbështetës e

8 Dokument i Punës për Mësimdhënësi Mbështetës, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Departamenti i Arsimit Parauniversitar, Njësia e Arsimit Special <https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/06/forma-e-planifikimit-dhe-raportimit-te-punes-se-me-suesve-mbeshtetes-4.pdf>

9 Udhëzimit Administrativ 24/2014 Shndërimi i Klasave të Bashkëngjitura në Dhoma Burimore, Republika e Kosovës, Gazeta Zyrtare, 2014 <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10246>

vështirëson zbatimin e planeve individuale zhvillimore dhe identifikimin e fushave ku fëmijët mund të vazhdojnë të zhvillohen më tutje.

Shembuj të përgjigjeve nga intervistimi i fëmijëve me nevoja të veçanta

Pyetja: “Kush të ndihmon për detyra në klasë?” dhe “A të ndihmojnë shokët /shoqet?”

“Shumë shpesh nuk i kuptojnë detyrat dhe pastaj të gjitha duhet të bëhen në shtëpi”

- Nxënësi/ja O, në debati i organizuar në Mitrovicë Jugore.

“Shumë shpesh nuk arrijnë t’i bëjnë detyrat se nuk e kuptojnë lëndën”.

– Nxënësi/ja P, në debatin e organizuar në Gjakovë.

Ndërkaq, diskutimet me nxënës përgjatë organizimit të debateve vetëm e kanë thelluar dhe më shumë nevojën për mësimdhënës mbështetës për fëmijët me nevoja të veçanta në klasa të rregullta. Sipas diskutimeve konsiderohet që, në shumë pak shkolla fillore në Kosovë ka prezencë të mësimdhënësve mbështetës, situatë kjo që shfaqet edhe më e mangët në vendet rurale dhe fshatrat në Kosovë. Në të shumtën e rasteve të deklaruara, një mësimdhënës mbështetës është përgjegjës për më shumë se një shkollë. Si pasojë, mësimdhënësit detyrohen të alokojnë vetëm një (1) ditë të javës në një shkollë, me dy deri në tre (2-3) orë punë me fëmijë në nevojë për mësim mbështetës. Nxënësit kanë shprehur që koha që kalojnë me një mësimdhënës mbështetës në klasë është e pakët në krahasim me nevojën e madhe për mbështetje në të nxënë nga disa nxënës. Sipas nxënësve, lëndët në të cilat kryesisht nxënësit me nevoja të veçanta marrin mbështetje shtesë janë gjuha shqipe, gjuha angleze, dhe matematika. Gati në të gjitha rastet, janë fëmijët vetë që ndihmojnë njëri-tjetrin për të kuptuar më mirë detyrat apo për të përfunduar detyrat e kërkuara.

Shembull nga diskutimet me fëmijë në debatet e organizuara:

“Ju nimojmë kaniher, shumicën e herave na nuk shkojmë me ju ndihmu po

● Në të shumtën e rasteve të deklaruara, një mësimdhënës mbështetës është përgjegjës për më shumë se një shkollë. Si pasojë, mësimdhënësit detyrohen të alokojnë vetëm një (1) ditë të javës në një shkollë, me dy deri në tre (2-3) orë punë me fëmijë në nevojë për mësim mbështetës.

veq ja'u dhojmë detyrat e gatshme.” – Nxënësi/ja P, në debatin e organizuar në komunën e Ferizajit.

## 6. Nevoja për diagnostikim të saktë

Sipas, nenit 2 të Udhëzimit Administrativ Nr. 16/2017 për Vlerësimin Pedagogjik të Fëmijëve me Nevoja të Veçanta Arsimore<sup>10</sup> (në vazhdim “UA për Vlerësimin Pedagogjik të Fëmijëve me Nevoja të Veçanta”), vlerësimi pedagogjik i nënshtrohen të gjithë fëmijët që kanë nevoja të veçanta arsimore. Ndër të tjera sipas nenin 3 dhe nenit 4 të UA për Vlerësimin Pedagogjik të Fëmijëve me Nevoja të Veçanta, vlerësimin pedagogjik të fëmijës e bënë ekipi i cili emërohet nga komuna e që përbëhet nga psikolog/e, pedagog/e, punëtor/e social/e, mësimdhënës mbështetës si anëtarë të përhershëm si dhe anëtarë të tjerë që ftohen sipas nevojës si kujdestari/ja e klasës dhe ekspertë varësisht llojit të nevojës së veçantë të fëmijës. Ky ekip ka nën kompetencë të bëjë vlerësimin pedagogjik për pjesëmarrjen dhe performancën e fëmijës në procesin arsimor bazuar në nevojat individuale të fëmijës; të përcaktoj institucionin arsimor në të cilin fëmija do të vijoj edukimin dhe arsimin; përcaktoj llojin e mësimdhënies; shërbimet e mbështjetjes; pajisjet dhe instrumentet e nevojshme ndihmëse; shërbimet rehabilituese si dhe transportin e përshtatshëm.

Analiza e raporteve ekzistuese në Kosovë, raport si Analiza e situatës nga UNICEF, tregon që mungesa e diagnostikimit të saktë, mungesa e profesionistëve adekuat dhe mungesa e instrumenteve adekuate është shumë evidente. Ky është hapi kryesor në trajtimin dhe zhvillimin e fëmijëve me nevoja të veçanta.

Pasaktësia në diagnostikim është vërejtur nga hulumtuesit tonë në terren gjatë monitorimit të bërë në klasa të rregullta me përfshirje të fëmijëve me nevoja të veçanta.

Rreth 65% të fëmijëve në mostrën tonë janë paraqitur si të diagnostikuar me spektër të autizmit sipas informacioneve të mësimdhënësve dhe

Rreth 65% të fëmijëve në mostrën tonë janë paraqitur si të diagnostikuar me spektër të autizmit sipas informacioneve të mësimdhënësve dhe drejtorëve/eve të shkollave të përzgjedhura në hulumtim. Mirëpo, hulumtuesit me sfond/kualifikim psikologjik kanë vërejtur që rreth 30% të fëmijëve nuk i kanë shfaqur simptomat tipike të autizmit.

<sup>10</sup> Udhëzimi Administrativ Nr. 16/2017 për Vlerësimin Pedagogjik të Fëmijëve me Nevoja të Veçanta Arsimore, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, 2017 <https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/12/16-ua-masht-nr-16-vleresimi-pedagogjik-i-femijeve-me-nevoja-te-veçanta-arsimore.pdf>

drejtorëve/eve të shkollave të përzgjedhura në hulumtim. Mirëpo, hulumtuesit me sfond/kualifikim psikologjik kanë vërejtur që rreth 30% të fëmijëve nuk i kanë shfaqur simptomat tipike të autizmit. Ndër të tjera, mungesa e diagnostikimit të saktë e pamundëson përpilimin dhe aplikimin e planeve individuale.

Kjo nevojë nuk është diskutuar me fëmijët në debatet e organizuara por është elaboruar më shumë si problem gjatë fokus grupeve si metodë tjetër e aplikuar e hulumtimit dhe mund të gjendet në faqen 30.

## **7. Nevoja për infrastrukturë të përshtatshme**

Sipas, nenit 5, paragrafit 7 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar ndër detyrat e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ndër të tjera përcaktohet të jetë dhe ofrimi i ndihmës teknike ndaj komunave për të siguruar përshtatshmërinë e ndërtesave shkollore dhe të pajisjeve sipas standardeve ndërkombëtare për shëndet dhe siguri, si dhe për mbrojtje të mjedisit, për të siguruar qasje të nxënësve dhe punonjësve me aftësi të kufizuara dhe pajisjet ndihmëse për përkrahjen e arsimit gjithëpërfshirës. Përshtatmëria e mjedisit shkollor për fëmijët me nevoja të veçanta konsiderohet si një prej parimeve bazë për të lehtësuar mësim-nxënien e fëmijëve dhe mbi të gjitha për t'iu ofruar kushte të qasshme karshi qëllimit për një arsim gjithëpërfshirës. Mirëpo, gjatë hulumtimit në terren është vërejtur që shkollat fillore kanë mungesë të infrastrukturës adekuate për fëmijët me nevoja të veçanta nisur nga cilësia e objektit të shkollës, vjetërsia dhe plani, shkallët brenda objekteve shkollore penalizojnë qasjen e fëmijëve me nevoja fizike, por në raste të caktuara ato janë të ngushta, të rrëshqitshme dhe të pa përshtatshme për fëmijë qoftë me nevoja të veçanta apo dhe me zhvillim tipik. Disa shkolla, e pamundësojnë qasjen qysh në hyrje duke qenë se nuk kanë pjerrtësinë për ti plotësuar kushtet e fëmijëve me nevoja të veçanta fizike.

Në anën tjetër sa i takon arkitekturës dhe fizikalitetit gati se asnjë shkollë nuk i përmbushë kushtet e tualeteve duke mos pasur tualete të veçanta për fëmijët me nevoja të veçanta fizike si dhe kanë mungesë të madhe higjienike dhe sanitarie. Nën të njëjtin kontekst, qasja në salla sportive për

Sipas fëmijëve, kushtet në shkolla fillore në Kosovë nuk janë gjithmonë të mira, e në shumë raste as edhe të pranueshme. Fëmijët kanë pohuar që gjendja higjienike në shkollat e tyre është shumë e rëndë, duke filluar nga mungesa e mjeteve higjienike, deri tek gjendja e dyerve dhe pllakave në tualeteve.

shkollat që kanë si dhe zhvillimi i orës së edukatës fizike në ambiente të brendshme të sallave sportive është gati se i pamundur dhe i paqasshëm për fëmijët me nevoja të veçanta fizike. Fëmijët me diagnoza të ndryshme që janë pjesë e një klase sfidohen dhe me probleme të tjera infrastrukture për shembull ndriqimi brenda një klase nuk është i përshtatshëm për të gjithë, bankat dhe karriket në raste të tjera janë të vjetëruara dhe jo adekuate për secilin fëmijë. Madhësitë e klasave (klasa të vogëla) në raste të caktuara janë penalizuese po ashtu për ti mbajtur fëmijët të bashkuar ose dhe për të ju përshtatur specifikave të diagnozave për shembull disa fëmijëve u duhet më shumë hapësirë, disa duhet të ulur përpara për shkak të dëgjimit apo dhe shikimit, ndërkaq fëmijë të tjerë kanë nevojë të ulen afër dritareve, të qëndrojnë vet apo në grup. Shumë shkolla nuk ofrojnë kënde të përshtatshme jashtë rutinës së klasës ku fëmijët do të mund të uleshin ose thjesht ta kalonin kohën e lirë.

Në anën tjetër, një pjesë e konsiderueshme e shkollave fillore nuk kanë shkallë emergjente e as plan për reagim emergjent. Përderisa, në raste të caktuara shkollat që posedonin shkallët emergjente i mbyllnin ato me qelës apo i përdornin për nevoja të tjera.

Ambienti i jashtëm po ashtu, sipas hulumtuesve në shkolla të caktuara kishte mangësitë e tij sepse disa shkolla ishin të lokalizuara në hapësira të papërshtatshme në qendra të qytetit ku kishte qarkullim të madh automjetesh por dhe mungesë trotuaresh sa i takon lëvizjes deri në shkollë të fëmijëve me nevoja të veçanta fizike. Në shumicën e rasteve kur trotuaret për këmbësor ekzistonin ato përdorehin si vendparkingje për vetura. Ndërkaq, shkolla të caktuara kishin mungesë parqesh dhe gjelbërimi në oborret e tyre.

Diskutimet e realizuara me fëmijë me nevoja të veçanta dhe me zhvillim tipik në 7 regjionet e mëdha të vendit përmes debateve të organizuara e fuqizuan dhe më tej të gjeturën bazë. Sipas fëmijëve, kushtet në shkolla fillore në Kosovë nuk janë gjithmonë të mira, e në shumë raste as edhe të pranueshme. Fëmijët kanë pohuar që gjendja higjienike në shkollat e tyre është shumë e rëndë, duke filluar nga mungesa e mjeteve higjienike, deri tek gjendja e dyerve dhe pllakave në tualeteve. Disa nga shkollat më të reja apo



të renovuara me anë të fondeve të jashtme, kanë arritur të rregullojnë këtë çështje, mirëpo fëmijët nga shumica e shkollave të tjera kalojnë kohën në ambiente jo higjienike dhe të dëmshme për shëndetin e tyre. Përveç kësaj, edhe gjatë diskutimeve është potencuar që disa nga shkollat ende kanë mungesë të sallave të edukatës fizike, mungesë të laboratorëve për punë praktike, dhe mungesë të projektorëve apo mjeteve të tjera teknologjike. Nxënësit janë ankuar edhe për çështje të inventarit të shkollës, ku përveç që ka pasur mungesë të mjeteve shtesë për mbajtjen e orës mësimore, edhe karriket, bankat shkollore, dhe orenditë janë në gjendje shumë të rëndë. Ky problem madhor në shkolla, ka gjenezën edhe më në bazë. Fëmijët me nevoja të veçanta fizike e kanë të pamundur të lëvizin nga një ambient në tjetrin brenda shkollës pa ndihmën e dikujt, me raste ndonjë personeli të shkollës apo shok/shoqe të klasës.

Shembuj nga diskutimet me fëmijë në debatet e organizuara:

- “Shkolla jonë ka vend ku mujnë me hyp fëmijët me karrocë, ama veq në hymje të shkollës, e në kat të dytë jo.” – Nxënësi/Ja Q, në debatin e organizuar në Gjakovë.

- “Banjot i kemi të vjetra, është diskutuar në shkollë, por nuk është zgjidhë problemi.”- Nxënësi/Ja P, në debatin e organizuar në komunën e Prishtinës.

- “Nuk kemi sallë të edukatës fizike e as laboratore në shkollë.” – Nxënësi/Ja R, në debatin e organizuar në Prizren.

### **Fokus Grupet**

Me qëllim të pasurimit të rezultateve të hulumtimit, janë realizuar shtatë sesione të fokus grupeve, në këto komuna: Prishtinë, Prizren, Pejë, Gjakovë, Ferizaj, Mitrovicë dhe Gjilan. Pjesëmarrës në këto sesione ishin drejtorë/e të shkollave, mësimdhënës/e, mësimdhënës/e mbështetës/e, prindër të fëmijëve me nevoja të veçanta, pedagogë dhe psikologë të shkollave. Këto sesione shërbyen si sesione plotësuese të hulumtimit në terren, me qëllim të nxjerrjes së përfundimeve dhe rekomandimeve për adresim dhe plotësim të nevojave të fëmijëve me nevoja të veçanta në arsimin fillor në Kosovë.

Sipas tyre, nevojitet përmirësim drastik i kushteve në arsim.

Gjatë sesioneve të fokus grupeve u diskutuan rezultatet e hulumtimit kuantitativ, njëherit nevojat e fëmijëve, si dhe u gjeneruan rekomandime se si të adresohen ato. Në sipërfaqe dolën një numër aspektesh që vështirësojnë përvojat me mësim-nxënie, ato pedagogjike, sociale, logjistike, etj. të fëmijëve me nevoja të veçanta gjatë procesit edukativ.

Megjithatë, lehtësuesi i sesioneve ka vërejtur në disa raste se deklaratat e pjesëmarrësve janë dhënë në kontekst të vetëmbrojtës, në pamundësi për të ofruar përgjigje konkrete. Më poshtë janë elaboruar përfundimet e nxjerra nga këto sesione duke adresuar secilën nevojë në detaje.

### **1. Nevoja për përfshirje dhe mbështetje në procesin mësimor**

Përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta në procesin mësimor shihet si sfidë edhe nga stafi edukativ por edhe nga prindërit. Arsyet që e vështirësojnë atë duken të jenë mjaft të polarizuara. Në njërën anë gjendet stafi mësimor (mësimdhënësit, mësimdhënësit/et mbështetës/e, drejtorët/et e shkollave, etj.) të cilët mendojnë se këta fëmijë janë mjaft të përfshirë në procesin mësimor dhe se sistemi aktual po u ndihmon dukshëm për të arritur rezultate pozitive në mësim. Ndërkaq, në anën tjetër janë pozicionuar ata që e shofin gjithëpërfshirjen si qasje jo-funksionale drejt rezultateve pozitive në mësim, përkundër rekomandimeve dhe rregulloreve shtetërore. Ky grup argumenton se në sistemin aktual shkollor, nuk ekzistojnë kushtet e mjaftueshme për të ju siguruar fëmijëve me nevoja të veçanta një përvojë pozitive pedagogjike dhe të përshtatshme për të arritur sukses në mësim-nxënie. Sipas tyre, nevojitet përmirësim drastik i kushteve në arsim, si p.sh. një numër i shtuar i mësimdhënësve dhe mësimdhënësve mbështetës, mjeteve konkretizuese, aktiviteteve që rrisin mundësitë e socializimit, përpjekje për diagnostikim të saktë si dhe përmirësim i infrastrukturës shkollore, në mënyrë që klasat gjithëpërfshirëse të funksionojnë.

Edhe prindërit e fëmijëve me nevoja të veçanta ishin të polarizuar në këto pikëpamje. Disa prindër ndajnë mendimin se fëmijët e tyre janë mjaft të përfshirë në procesin mësimor, përderisa tjerët e shihnin sistemin si jo-funksional dhe nuk ishin të kënaqur me nivelin e përfshirjes.

Për shembull, një prind nga komuna e Ferizajit, fëmija i së cilës vuante

nga një dëmtim fizik në gjymtyrë, ishte e kënaqur me mënyrën se si trajtohej fëmija i saj nga mësimitdhënësit gjatë disa lëndëve, mirëpo tregon se si ky fëmijë nuk mund të përfshihet në lëndën e matematikës, gjegjësisht në gjeometri, ngase nuk ka mundësi të përdorë vizore dhe mjete tjera të nevojshme për të cilat nuk ka asistencë nga askush. Ndërkaq një prind nga Peja, ishte më shumë i brengosur me faktin se fëmija i tij nuk po arrinte të përvetësonte materialin mësimor në shkenca ekzakte, për shkak se me atë fëmijë nuk zbatohet me përpikshmëri plani individual mësimor. Megjithatë, disa prindër deklaruan se në rastet e prezencës së mësimitdhënëses mbështetëse në procesin mësimor, fëmijët e tyre kishin përparuar dukshëm në rrafshin intelektual.

Shkollat kanë për obligim të përgatisin plan individual mësimor, të adoptuar për nxënësit me nevoja të veçanta. Në shumicën e rasteve, përgatitja e këtij plani mbikqyret nga një ekip profesional i quajtur “Ekipi Vlerësues”. Përrjashtimi vlen vetëm në disa komuna, sikurse Peja, ku Ekipi Vlerësues ka zvogëluar apo edhe pezulluar punën për shkak të mos kompenzimit financiar nga komuna. Sipas mësimitdhënësve, planet individuale e ndihmojnë përfshirjen e nxënësve në mësim. Megjithatë, ata shpesh herë hasin në vështirësi karshi zbatimit të këtyre planeve qoftë nga mungesa e kohës, numri i lartë i nxënësve në klasë apo thjesht nga mungesa e trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve të mësimitdhënësve në edukimin gjithëpërfshirës. Këto ishin disa nga deklaratat e shpeshta të mësimitdhënësve të rregullt, ndaj pyetjes se pse disa fëmijë ndjehen të pa përfshirë në procesin mësimor?

- “Si mund të ja kushtoj tërë orën e mësimit një fëmijë kur kam edhe së paku 30 nxënës tjerë në klasë?” - mësimitdhënësi, Pejë;

- “Me qenë se kam shumë nxënës, nuk arrij dot të përqëndrohem vetëm tek një fëmijë që kërkon vëmendjen time të shtuar, prandaj duhet të angazhohet ndonjë asistente apo të vijë vet prindi në shkollë që të kujdeset për të” - mësimitdhënësi, Mitrovicë;

- “Shumë nga fëmijët e diagnostikuar me çrregullime në të menduar apo në sjellje, nuk pranojnë të kalojnë më shumë se një orë në klasë, duke filluar të bërtasin dhe ndërpresin procesin mësimor, prandaj si ta menaxhoj unë?” - mësimdhënëse, Gjakovë

- “Si të ju ndihmoj unë fëmijëve me nevoja të veçanta kur nuk jam trajnuar asnjëherë në edukim gjithëpërfshirës?” - mësimdhënëse, Ferizaj.

Sipas drejtorëve dhe mësimdhënësve, realizimi i i mësimimit të ciklit të lartë ku përfshihen një numër më i madh i mësimdhënësve, është më i vështirë për dallim nga cikli i ulët, e sidomos nëse punohet me mësimdhënës të trajnuar në edukimin gjithëpërfshirës .

Fatkeqësisht, në disa komuna është vërejtur se ekziston qëndrimi se fëmijët me nevoja të veçanta do të kishin më shumë sukses arsimor nëse do të vijonin mësimin në klasa të bashkëngjitura (speciale).

## **2. Nevoja për përdorim të metodave konkrete gjatë orës mësimore**

Të gjitha palët pjesëmarrëse në fokus grupe pajtohen se mjetet konkretizuese janë nevojë parësore për mbarëvajtjen kualitative të orës mësimore me fëmijë me nevoja të veçanta. Mjetet ndihmojnë në konkretizimin e materialit dhe lehtësojnë procesin e mësimdhënies, posaçërisht kur ekziston plani individual. Shumica pajtohen se mungesa e tyre krijon shumë vështirësi edhe për mësimdhënësin/en në shpjegim, por pa dyshim edhe në përpjekjet e nxënësit/es në nxënie.

Të gjitha komunat deklaruan se shkollat nuk posedojnë as minimumin e nevojshëm të këtyre mjeteve. Ato pak mjete që posedojnë, janë harta gjeografike të cilave shpeshherë nuk ju dihet lokacioni apo është shumë vështirë qasja në mjete sepse duhet kërkuar ato për përdorim sa herë që janë të nevojshme nga drejtori/ja i/e shkollës.

Mjete konkretizuese posedojnë vetëm disa mësimdhënës mbështetës, kryesisht materiale (materiale të printuara, letra me ngjyrë, etj.) që i kanë sajuar vetë apo me anë të donacioneve nga OJQ-të që eventualisht kanë

trajnuar këta mësimdhënës mbështetës. Megjithatë, këto raste janë shumë të rralla.

Në anën tjetër, mësimdhënësit e zakonshëm deklaruan se as nuk posedojnë njohuri të mjaftueshme për përdorim të mjeteve konkretizuese gjatë lëndëve të tyre, edhe po të i posedonin ato. Prandaj u rekomandua që së pari të bëhen përpjekje për të siguruar këto mjete në nivel të MASHT, dhe si hap i dytë, të organizohen trajnime në edukimin gjithëpërfshirës dhe përdorimin e tyre.

### 3. Nevoja për shoqëri

Rezultatet e hulumtimit kuantitativ treguan se një përqindje e madhe e fëmijëve ndihen të vetmuar, sidomos gjatë pushimeve në shkollë. Pjesëmarrësit e fokus grupeve reagues me deklarata vetë-mbrojtjeje ndaj kësaj gjetje duke mohuar të kenë vërejtur diçka të tillë. Kjo dëshmon se ekziston një diskrepancë në mes të perceptimeve se sa të vetmuar apo socializuar ndihen këta fëmijë. Mësimdhënësit ndajnë opinionin se shokët dhe shoqet e klasës bëjnë përpjekje të mëdha për t'i shoqëruar dhe përfshirë nxënësit me nevoja të veçanta në klasë. Ndërkaq, prindërit kishin përvoja të ndryshme në këtë aspekt. Disa prej tyre u treguan të brengosur me faktin se fëmija i tyre ndihet mjaft i izoluar në shkollë. Në të kundërtën, disa prindër ndiheshin se fëmijët e tyre janë shumë të përkrahur nga shoqëria në shkollë, gjë që e bën tranzicionin nga cikli i ulët (ku punohet me më pak mësimdhënës) në ciklin e lartë, më të përbalueshëm.

Është brengosëse që stafi edukativ përpjekjet për socializimin e fëmijëve me nevoja të veçanta, i kufizon në diskrecionin e shokëve dhe shoqeve të klasës. Shkollat duhet të përpiqen për të organizuar aktivitete sociale që sigurojnë përfshirjen e të gjithë fëmijëve në ambientin shkollor.

### 4. Nevoja për aktivitete jashtë-shkollore dhe lëndë kulturore si Art Figurativ dhe Muzikor

Pothuajse në të gjitha komunat ku janë mbajtur fokus grupet është vërejtur se iniciimi i aktiviteteve jashtë-shkollore për fëmijët me nevoja të veçanta nuk është adresuar me ndonjë përpjekje të konsiderueshme. Stafi

●  
Është brengosëse që stafi edukativ përpjekjet për socializimin e fëmijëve me nevoja të veçanta, i kufizon në diskrecionin e shokëve dhe shoqeve të klasës.

mësimor duket të jenë të vetëdijshëm rreth përparësive që aktivitetet shpesh sjellin, mirëpo janë të limituar në përpjekjet për të shtuar ato. Për shembull, për shumicën e shkollave, aktivitete jashtë-shkollore shpesh nënkuptoheshin festat shkollore (sikurse festa e pavarësisë, festa e shkollës, etj.), por asgjë të tipit si: organizimi i shfaqjes së një filmi edukativ, nga ana e mësimdhënësës mbështetëse, inspiruar nga puna e disa organizatave jo-qeveritare (OJQ).

Fatkeqësisht, diskutimi nuk solli ndonjë rekomandim konkret lidhur me këtë nevojë, mbase nga pamundësia e pjesëmarrësve për të kuptuar realisht rëndësinë e organizimit të aktiviteteve të tilla.

Pothuajse unanimisht, pjesëmarrësit ishin të pajtimit që fëmijët me nevoja të veçanta preferojnë shumë lëndët që janë më kreative dhe interaktive. Njëherit, të gjithë ishin të vetëdijshëm se këto lëndë u ndihmojnë fëmijëve në përmirësimin e gjendjes emocionale dhe shkathtësive të shprehjes.

Megjithatë, disa prindër u shprehën të brengosur në rast se shkollat vendosin të koncentrojnë përpjekjet vetëm drejtë këtyre lëndëve. Ata mendonin se fëmijëve ju nevojiten patjetër të mësojnë edhe shkathtësi konkrete nga lëndët ekzakte dhe shkencore, për të funksionuar në mënyrë të pavarur. Në lidhje me këtë, një prind nga Prishtina shprehet kështu: “Fëmiju im duhet të kuptojë në thelb se çka është dhe si funksionon rryma, ashtu që të mos elektrizohet”.

Vlenë të përmendet se pjesëmarrësit e çdo fokus grupi nga të gjitha komunat janë shprehur se posedojnë instrumente të mjaftueshme për realizimin e lëndës së muzikës. Deklaratat e tilla nuk kanë tingëlluar shumë bindëse, me qenë se rrallë-herë janë përcjellur dhe kanë mundur të përcillen me shembuj konkret.

## **5. Nevoja për mësimdhënës/e mbështetës/e**

Nëvoja për rritjen e numrit të mësimdhënësve mbështetës ishte deklarata më konsistente në të gjitha komunat. Sipas pjesëmarrësve, numri i vogël i këtij stafi vështirëson shumë përfshirjen e fëmijëve në procesin mësimor. Aktualisht, është punësuar një numër shumë i vogël i tyre. Në shumicën e rasteve një mësimdhënës mbështetës punon në disa shkolla

gjatë javës. Për shembull në Ferizaj një mësimdhënëse mbështetëse udhëton në 6 shkolla dhe nuk mundet me qenë prezente në të gjitha orët mësimore për një fëmijë.

Në anën tjetër, mësimdhënësit e rregullt nuk arrijnë të konkretizojnë të gjitha informatat nga materialet mësimore për fëmijët me nevoja të veçanta, dhe shpeshherë as nuk posedojnë shkathtësi pedagogjike që të zbatojnë planet individuale për ata fëmijë. Prandaj, u rekomandua se nëse nuk ka mundësi të punësohen më shumë mës mbështetës, atëherë së paku të ofrohen më shumë trajnime pedagogjike.

Gjatë diskutimeve u potencua se në shkolla mungojnë edhe asistentët mbështetës. Si pasojë, fëmijët me aftësi fizike të kufizuara, varen nga shoku, shoqja e klasës apo prindërit që duhet të qëndrojnë fizikisht në afërsi të klasës gjatë orëve të mësimt, për të lëvizur, përdorë mjete didaktike (laps, vizore, etj.) gjatë procesit mësimor, si dhe për t'i asistuar në kryerjen e nevojave fiziologjike. Drejtori i një shkolle fillore në Gjiilan tregoi se disa prindër detyrohen të paguajnë asistent mbështetës që fëmija i tyre të mund të vijojë mësimin.

Në disa raste, zyrtarët e shkollës as nuk përpiqen të adresojnë në institucione përkatëse nevojën për punësim të mësimdhënësve mbështetës të profileve të caktuara në shkollën e tyre. Rast tipik është shkolla “Mazllum Këpuska” në Gjakovë. Sipas mësimdhënësve, në këtë shkollë vijnë mësimin një numër i konsiderueshëm i nxënësve me nevoja të veçanta, po që sipas njohurive të stafit, asnjëherë nuk është ndërmarrë ndonjë hap për të punësuar staf mbështetës për fëmijë me nevoja të veçanta apo për të adresuar këtë sfidë. Në veçanti, u përmend se kjo shkollë nuk kishte synuar as përfitim nga programet e OJQ-ve që kanë arritur të mbështesin këtë kauzë në komunat tjera në Kosovë duke mundësuar kështu angazhimin e mësimdhënësve mbështetës.

Si përfundim, u rekomandua që të bëhet më shumë presion në institucione shtetërore dhe Drejtoritë Komunale të Arsimit për mbështetje në këtë drejtim.

## 6. Nevoja për diagnostikim të saktë

Rezultatet e fokus grupeve treguan se diagnostikimi i saktë paraqet sfidë jo vetëm për fëmijët, por edhe për palët e interesuara sikurse mësime dhënësit/et, drejtorët/et e shkollave, pedagogët, mësime dhënësit mbështetës, etj. që synojnë të adresojnë nevojat e nxënësve me nevoja të veçanta.

Problemi kryesor qëndron në atë se shumica e shkollave nuk kanë të punësuar psikolog/e që bënë vlerësimin profesional të gjendjes mentale të fëmijëve. Si pasojë, në disa raste janë prindërit ata që detyrohen të paguanë për shërbime të tilla. Kjo i dëmton fëmijët me kushte të rënda socio-ekonomike që në shumicën e rasteve, as që arrijnë të diagnostikohen. Për shembull, një mësime dhënëse mbështetëse në komunën e Ferizajit, u deklaroi se dyshon që ka disa nxënës me zhvillim të vonuar në klasën e saj kujdestare, nxënës që do të mund të përparonin me ndjekjen e një plani individual mësime. Mirëpo, ajo u shprehë se nuk mund të kërkojë nga prindërit e këtyre fëmijëve që të drejtohen tek psikologu privat (si mundësi e vetme në rastin e Ferizajit) në mënyrë që diagnostikimi i nevojshëm të realizohet pasi që familjet e këtyre fëmijëve jetojnë me të ardhura shumë të ulëta. Një sfidë tjetër është se edhe kur ekziston mundësia e diagnostikimit, ndodhë që diagnozat që vihen të jenë jo të sakta. Sipas disa psikologëve shkollor, diagnostikimi i ngutur apo jo-profesional, promovon vërjen e një diagnoze të hasur shpesh, si p.sh. zhvillim i vonshëm mendor. Kjo dëmton përparimin e fëmijëve dhe pamundëson qasjen e duhur pedagogjike. Sipas, mësime dhënësvmbështetës, diagnozat e pasakta mundësojnë të zbatohet një plan mësime jo adekuat, me ç'rast ngadalëson zhvillimin intelektual të fëmijëve me nevoja të veçanta.

Diagnostikimi si proces, rrezikohet edhe nga prindërit që refuzojnë të diagnostikojnë fëmijët e tyre pas rekomandimit të mësime dhënësit/es. Sipas, drejtorëve/eve të shkollave, janë mjaftë të shpeshta rastet kur prindërit tentojnë të fshehin faktin se fëmija i tyre plotëson ndonjë kriter për diagnostikim. Kjo pa dyshim se dëmton shumë fëmijun i cili përveç se nuk mund të marrë kujdesin shëndetësor që i nevojitet, përjeton ngecje edhe në aspektin edukativ.

● Diagnostikimi si proces, rrezikohet edhe nga prindërit që refuzojnë të diagnostikojnë fëmijët e tyre pas rekomandimit të mësime dhënësit/es.



## 7. Nevoja për infrastrukturë të përshtatshme

Një pjesë e shkollave të cilat janë vizituar dhe prezente nën përfaqësim, janë të pajisura me pjerrina, por që konsiderohet se nuk ndihmojnë shumë qasjen e fëmijëve me nevoja të veçanta fizike, me qenë se shumë klasa janë të pozicionuara në katin e dytë ku mungon lifti dhe qasja është e mundur vetëm përmes shkallëve. Në disa raste shkollat detyrohen të zhvendosin tërë klasën ku vijon mësimin një nxënës me nevoja të veçanta në një kat më poshtë. Kjo mund të jetë përvojë negative për nxënësin me qenë se e stigmatizon atë dhe e bënë të barta përgjegjësi për rikolim, para shokëve dhe shoqeve të klasës.

Mungesa e infrastrukturës adekuate duket të jetë problem edhe për mësimdhënësit mbështetës, të cil nuk kanë zyre apo kabinet ku mund të punojnë me raste specifike. Për shembull, mësimdhënësit që duan të testojnë një nxënës që vuan nga ç'rregullimi i deficitit të vëmendjes dhe hiperaktivitetit, nuk kanë hapësirë të përshtatshme për t'a realizuar këtë vlerësim.

Të njëjtit u shprehen se nuk kanë as hapësirë për përgatitjen eventuale të mjeteve konkretizuese dhe janë të varura nga zyret e drejtorëve/eve të shkollave ku punojnë.

Pjesëmarrësit rekomanduan që udhëheqësit e shkollave të jenë më vokal në lidhje me mangësitë në infrastrukturë.

**rekomandime**



## **Rekomandime**

- 1** Fëmijët me nevoja të veçanta, pjesë të klasave të rregullta në shkolla fillore , meritojnë trajtim të barabartë dhe jo- diskriminues;
- 2** Mbështetja duhet të ofrohet vazhdueshëm në klasë, në proces të mësim-nxënies dhe integrim shoqëror;
- 3** Drejtoritë Komunale të Arsimit, të ri-strukturojnë ndarjen buxhetore për shkolla, dhe të përkrahin furnizimin e shkollës me mjete konkretizuese e didaktike që i përshtaten fëmijëve me nevoja të veçanta;
- 4** Drejtoritë e Shkollave, t'i masin nevojat e secilit fëmijë me nevoja të veçanta dhe të propozojnë plan financiar konkret për pajisjen e shkollës me mjete konkretizuese dhe didaktike;
- 5** Mësimdhënësit t'i nënshtrohen proceseve trajnuese e përditësuese në përdorim të metodave inovative e konkretizuese që i shërbejnë procesit të mësim-nxënies të fëmijëve me nevoja të veçanta;
- 6** Të krijohen mekanizma apo organe lehtësuese brenda shkollës që lehtësojnë përfshirjen sociale;
- 7** Të zbatohet korrektësisht, kurrikula bërthamë që ka për tendencë zbërthimin e shkathësive, dhe mirëqenies; të ofrohet mësim plotësues për mbështetje më efektive të të nxëniet;
- 8** Drejtoritë e Shkollave dhe Drejtoritë Komunale për Arsim të zbatojnë përpikmërisht UA për Aktivitete Jashtë-shkollore; Të përfshihen fëmijët me nevoja të veçanta në më shumë aktivitete të tilla;
- 9** Mësimdhënësit të përfshijnë në plan-program dhe metodologji inovative brenda orës mësimore që nxisin aktivitetin jashtë-kurrikular;
- 10** Të zbatohet Ligji për Arsimin Parauniversitar dhe UA për Shndërrim të Klasave të Bashkëngjitura në Dhoma Burimore për mësimdhënësit mbështetës;
- 11** Të inspektohet nga Inspektoriati për Arsim zbatimi i dispozitave ligjore për mësimdhënësit mbështetës si dhe të ofrohet alternativë konkrete që i

kontribuon zbatimit të mësimdhënies mbështetëse;

**12** Të përmbushet norma e personelit profesional jo-mësimdhënës për mbështetje pedagogjike-psikologjike për fëmijët me nevoja të veçanta;

**13** Të iniciohet procedurë dhe rregullativë adekuate për vlerësim pedagogjik/diagnostikim të fëmijëve me nevoja të veçanta;

**14** Të ngritet vetëdija e prindërve, kujdestarit/es dhe ajo shoqërore kundrejtë nevojës për diagnostikim të saktë si dhe kundër perceptimit diskriminues ndaj fëmijëve me nevoja të veçanta;

**15** Mësimdhënësit mbështetës dhe ata të rregullt duhet t'i përpilojnë Planet Individuale të Arsimit për secilin fëmijë që vlerësohet se ka nevojë për mbështetje; Mësimdhënësit mbështetës dhe ata të rregullt duhet të monitorohen karshi përmbushjes së këtij obligimi;

**16** Është e nevojshme të përmirësohet infrastruktura e shkollës të përshtatshme për fëmijët me nevoja të veçanta. Projektimet e shkollave të reja duhet të i përmbushin standartet e tilla ndërkaq ato ekzistente të zhvillojnë kritere përshtatshmërie infrastruktore për fëmijët me nevoja të veçanta





